



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2022:102840

Datë: 19.06.2024

Numri i dokumentit: 05833499

P.nr.76/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Dega në Leposaviq - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri- Islami, me bashkëpuntoren profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M.J, për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.836/2022 të datës 20.05.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 04.05.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Shaqir Sedolli dhe të akuzuarit M.J, më datën 05.06.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.J i biri i dhe, e gjinisë, i lindur më në Novi Pazar, tani me vendbanim në fshatin Majdevo Komuna e Leposaviqit, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 11.04.2022, rreth orës 20:30, njesia patrulluese e vijës së gjelbërt në rrugën alternative në fshatin Bistrica, komuna e Leposaviqit, gjate një kontrolli rutinë kane ndalur kamioni e tipit Mercedes, me targa te regjistrimit NP-076-EF, ngjyrë të gjelbërt, te cilën drejtonte tani i pandehuri dhe gjate kontrollit kane vërejtur se i njëjti ka qenë duke bartur dru për djegëje të cilan nuk ishin të damkosura dhe as nuk posedonte dokumentacion përcjellës.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 të KPRK-së (Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074).

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69 lidhur me nenin 140 par.1 të KPRK-së, dhe neneve: 364, 449, 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

S H Q I P T O N

- I. **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro, të cilin dënim- gjobë, obligohet ta paguaj brenda afatit prej (15) pesëmbëdhjetë ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se nuk e paguan këtë gjobë, atëherë gjoba do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i 'u përlllogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) dënim me gjobë.
- II. **OBLIGOHET** i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. **Kërkesë pasurore-juridike** nuk kishte.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.nr.836/2022 të datës 20.05.2022 kundër të akuzuarit M.J për shkak të veprës penale, Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 04.06.2024, në të cilën ka prezantuar Prokurori i Shtetit Shaqir Sedolli, i akuzuari M.J si dhe përkthyesi i gjykatës Hysen Mikollovci

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, Gjyqtarja e vetme gjykuese e ka njoftuar të pandehurin lidhur me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i pandehuri lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se ndjehet fajtor dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë ka mbështetur në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenë se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj një dënim sipas ligjit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 321 të KPP-se e lidhur me nenin 242 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti gjyqësor i incidentit me numër të rastit nr.2022-YNC-33 e datës 21.04.2022, raporti policor i datës 21.04.2022, deklarata e të pandehurit e datës 21.04.2022, foto dokumentacioni, informacionet për të kaluarën kriminale, verifikimi i personit përmes sistemit BMS dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari M.J ka kryer veprën penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me dyqind e pesëdhjetë (250) Euro gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Gjykata, si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe rrethanat tjera lehtësuese faktin se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, i njëjti ka treguar sjellje të mirë në gjykatë. Ndërsa, rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 lidhur me par.1 dhe nenit 452 par. 1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364, 452, 462 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Dega në Leposaviq

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.76/22 të datës: 19.06.2024

Bashkëpunorja Profesionale
Edita Koliqi

Gjyqtarja e vetme gjyquese
Qëndresa Tahiri- Islami

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.